



Informacione për prindërit – Shkollimi special

Të dashur prindër

Nxënësve me një të metë ose me probleme zhvillimi u qëndrojnë në dispozicion ofertat e shkollimit special. Këtu bëhet fjalë për të metat mendore, për ata trupore, të shikuarit, të dëgjuarit, të folurit si dhe për shqetësimet për spektrin e autizmit, pengesa të rënda në të mësuarit dhe problemet në sjellje. Në vijim ne do t'ju informojmë për detyrat e shkollimit special dhe të drejtat e saj në lidhje me këtë.

Kur ka nevojë fëmija për një shkollim special?

Një shkollim special merret në konsideratë, nëse nxënësja ose nxënësi nuk përkrahen siç duhet me ofertat e veçanta pedagogjike në shkollën e rregullt.

Në fillim bëhet gjithmonë një bisede në shkollë. Prindërit eventualisht së bashku me fëmijën e tyre, mësuesin, pedagogun shërues të shkollës, terapistin, ose terapistin si dhe edukatoren diskutojnë gjendjen momentale dhe paraqesin, nëse duhet të merret në konsideratë një shkollim special, një raport psikologjiko- shkollorë. Kjo duhet të tregoj në qoftë se është i nevojshëm një shkollimi special.

Në rast nevoje, shërbimi këshillues psikologjiko shkollor inkuadron persona të tjerë profesional (p.sh. mjek specialistë). Në një bisedë tjetër në shkollë me prindërit diskutohet raporti sqarues dhe i parashtrohet një propozim komisionit shkollor.

Komisioni shkollor, i mbështetur në raportin e sqarimit psikologjiko shkollor dhe pas dëgjimit të prindërve, vendos për nevojën e shkollimit special dhe formën e zbatimit të tij. Deri në ç'pikë mund të marr mësime një nxënëse ose një nxënës me nevojë të arsimimit special në klasën e rregullt, këtë e vlerëson dhe e vendos komisioni shkollorë sipas rrethanave të parashtuara. Ai mbështetet në raportin psikologjiko shkollor, eventualisht në ekspertizat profesionale si dhe në vlerësimet e dhëna nga shkolla e rregullt dhe prindërit e fëmijëve ose të rinjve përkatës.

Ofertë

Shkollimi special mund të integrohet sipas nevojave të fëmijës ose të rinjve në një shkollë të rregullt, në një shkollë speciale ditore ose në një konvikt special shkollor:

Shkollimi special i përshtatur (në klasën e rregullt)

Sistemimi krijohet sipas nevojave individuale të secilit nxënës. Përveç mësimit të mësuesit të klasës së rregullt, mund të caktohen edhe këto forma përkrahëse si në vijim:

- Mësim në grup (Teamteaching)
- Përkrahje individuale ose në grupe të vogla
- Terapi
- Shoqërim socialo pedagogjik
- Mbështetje nëpërmjet asistimeve
- Konsultim profesional specifik në lidhje me të metat për mësuesit dhe prindërit

Në rast nevoje mund të aranzhohet një përkujdesje jashtë shkollore, në kuadër të ofertave përkatëse të komunës, nëse është e nevojshme edhe me persona të tjerë përkrahës.

Shkollimi special ditor

Nxënësja ose nxënësi frekuenton mësimin në një klasë të shkollës speciale dhe në rast nevoje bën edhe terapi. Para dhe pas mësimit në shkollë si dhe gjatë mesditës ofrohet një përkujdesje socialo pedagogjike, në përputhje me orarin e hapjes së shkollës speciale.

ose: shkollat speciale ditore ofrojnë gjithashtu një përkujdesje veçanërisht në mesditë, në përputhje me orarin e hapjes së tyre.

Në rast nevoje mund të mundësohet një përkujdesje tjetër jashtë shkollës në shkollën speciale ose në komunën e banimit. Në qoftë se fëmija nuk mund ta bëjë vetë rrugën për në shkollë, atëherë organizohet për të një mjet i përshtatshëm transporti.

Konvikti i shkollës

Nxënësja ose nxënësi frekuenton mësimin në një klasë të shkollës speciale dhe në rast nevoje bën edhe terapi. Përkujdesja socialo pedagogjike në konviktin e shkollës i përshtatet nevojave të fëmijës ose të riut (sipas nevojës deri në 365 ditë në vit). Në qoftë se fëmija nuk mund ta bëjë vetë rrugën për në shkollë, atëherë organizohet për të një mjet i përshtatshëm transporti.

Financimi

Komuna dhe kantoni marrin përsipër të gjitha shpenzimet që duhen paguar për shkollimin special, terapitë, përkujdesjen socialo pedagogjike (në kuadër të orarit e hapjes të shkollës speciale) edhe transportin.

Prindërit marrin përsipër shpenzimet për:

- ushqimin (8.- Fr. për ushqimin e drekës ose 17.- Fr. në ditë në konviktin e shkollës ose vendstrehimin)
- ofertat për përkujdesje jashtë shkollës në kuadër të shkollimit special të integruar sipas rregullit tarifor të komunës tuaj.
- ofertat për përkujdesje jashtë orarit të hapjes së shkollës speciale ditore, sipas rregullit tarifor të komunës tuaj.
- shpenzimet shtesë sipas marrëveshjes me konviktin e shkollës

Të drejtat e prindërve

Prindërit bashkëpunojnë në kuadër të bisedës në shkollë që zhvillohet së paku njëherë në vit, në planin përkrahës (përcaktimin e lartpërmendur të qëllimeve përkrahëse) dhe në verifikimin e shkollimit special.

Prindërit që në fillim të shkollimit special orientohen për:

- të drejtat dhe mundësitë pjesëmarrëse të tyre
- sistemimin e saktë të shkollimit special, përkatësisht konceptin terapistik të shkollimit dhe të përkujdesjes së shkollës speciale
- organet kontrolluese përkatëse (komisioni shkollor ose sponsorizuesit dhe ministrinë e arsimit të kantonit të Cyrihut, zyra e shkollës fillore, sektori i pedagogjikës së veçantë, Telefoni: 043 259 22 91).

Kundër të gjitha vendimeve të komisionit shkollor mund të bëhet ankesë tek këshilli rajonal (Bezirksrat) përgjegjës.

Informacione / konsultim

Regjistri i shkollës speciale nën: www.vsa.zh.ch → Schulstufen & Schulen → Schulen → Sonderschulen

Koncepti në kuadër të shkollimit special të integruar nën: www.vsa.zh.ch → Schulbetrieb & Unterricht → Sonderpädagogisches → Sonderschulung → Sonderschulangebot

Procap- shërbim juridik për njerëzit me të meta, Tel. 062 206 88 77, www.procap.ch

Zyrat përkatëse për të metat specifike:

Të metat mendore:

- Pro Infirmis, zyrë konsultimi për prindër, Tel. 044 299 44 11, www.proinfirmis.ch

Të meta trupore:

- RGZ –konsultim i hershëm, Telefoni 044 380 37 65, www.rgz-stiftung.ch
- Shoqatë zvicerane për fëmijë me paralizë cerebrale, Tel. 031 308 15 15, www.cerebral.ch

Të metat e shikimit:

- Zyra e konsultimit e pedagogjikës së veçantë, Visoparent Schweiz, Tel. 043 355 10 20, www.visoparent.ch
- Low Vision Zentrum, Tel. 043 333 23 01, www.lowvisionzentrum.ch

Të metat e dëgjimit:

- Zyra e konsultimit për shurdhët, Cyrih, www.gehoerlosenfachstellen.ch

Autizëm:

- Shoqata “autismus link”, qendra kompetente për njerëzit me autizëm, Tel. 031 911 91 07, www.autismuslink.ch